

BASHKIA KORCE
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Date **16.09.2015**

Nga: **Bashkia Korce, rruga “28 Nentori”, 082 243353.**

Për: **Shoqerine “Pinderi” sh.p.k, adresa: Korce,Drenove,stabiliment druri,Rruga nacionale Korce-Erseke,km i 4-^{tert},perballe me fabriken e tullave.**

* * *

Procedura e prokurimit: **Kerkese per propozim**

Objekti: **“Blerje dru zjarri”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Kjo kontrate ka per qellim furnizimin me dru zjarri per Ndermarrjen e Sherbimeve Mbeshtetese te Arsimit dhe Çerdhes dhe te Njesive Administrative Mollaj,Voskop,Voskopoje,Vithkuq,Bulgarec dhe Lekas.**

Fondi limit: **7.227.500 lek**

Burimi i financimit: **Te ardhurat e Bashkise Korce Shpenzim operativ**

Data e zhvillimit te procedures se prokurimit: **07.09.2015**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] - Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët**

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

- 1. Shoqeria “Pinderi”sh.p.k, NIPT J78317009O me vleren:
7.223.370(shtate milion e dyqind e njezet e tre mije e treqind e shtatedhjete) lek**
- 2. Shoqeria “M.B Kurti”sh.p.k, NIPT J64103483H me vleren:
6.814.500(gjashte milion e teteqind e katermbedhjete mije e peseqind) lek**

* * *

Jane s’kualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1.Shoqeria “M.B Kurti” sh.p.k per arsye se:

-Shoqeria MB Kurti nuk ka paraqitur licence kodi III.7 A, leshuar nga QKL, Kontrate per shfrytezim te lendes drusore te shoqeruar me leje shfrytezimi te vlefshme per vitin 2015 dhe per njesasi jo me pak se 2478 mst ne kundershtim me kriteret e vendosura ne dokumentet e tenderit , shtojca 8,kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2 dhe 3.

Shoqeria MB Kurti per plotesimin e ketij kriteri ka paraqitur Kontrate huaperdorje lidhur me shoqerine “Semi”sh.p.k ,Licence Kodi III.7 A te shoqerise “Semi”sh.p.k,Kontrate shfrytezimi te lendes drusore dhe Leje shfrytezimi te shoqerise “Semi”sh.p.k.

Lidhur me dokumentacionin e mesiperm

Se pari: Shoqeria "MB Kurti"sh.p.k ne rast se nuk plotesonte e vetme kriteret per kualifikim duhej te kishte paraqitur marreveshje bashkepunimi me shoqerine "Semi"sh.p.k ne perputhje me nenin 74 VKM Nr 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik"

Se dyti: Edhe sikur te mereshin te mireqena dokumentet e paraqitura ato nuk plotesojne kriteret e vendosura ne dokumentet e tenderit. Konkretisht:

-Kontrata e huaperdorjes , e cila ne fakt eshte kontrate furnizimi,nuk ka te percaktuar sasine qe do te furnizohet.

- Kontrata per shfrytezim te lendes drusore dhe Leja e shfrytezimit nuk ka sasine e kerkuar prej 1477 m3 dhe per me teper I ka mbaruar vlefshmeria ne kundershtrim me kriteret e vendosura ne dokumentet e tenderit , shtojca 8,kriteret e vecanta per kualifikim , kapaciteti teknik pika 3, ku percaktohet shprehimisht "Te kete te pakten nje kontrate per shfrytezim te lendes drusore te lidhur me Drejtorine e Sherbimit Pyjor e shoqeruar me leje shfrytezimi te vlefshme per vitin 2015 dhe per nje sasi jo me pak se 2478 mst (ose 1477m3)."

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "**Pinderi**"sh.p.k, **adresa: Korce, Drenove, stabiliment druri, Rruga nacionale Korce-Erseke, km i 4- tert, perballe me fabriken e tullave**,se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **7.223.370 (shtate milion e dyqind e njezet e tre mije e treqind e shtatedhjete)lek, pa tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ndermarrjes te Sherbimeve Mbeshtetese te Arsimit dhe Çerdhes dhe Bashkise Korce** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kërkesa e per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 08.09.2015